



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 03 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1650/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI42/19

Parashtrues

Muhamet Prapashtica

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr.243/2018,të 12 nëntorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Prapashtica, me banim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetushmërinë e Aktgjykimin [PML. nr. 243/2017] të 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR. Nr.453/ 2017] e 9 marsit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PKR. nr.624/2008] e 15 qershorit 2017 të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) e 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 mars 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë. Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës më 14 mars 2019.
6. Më 18 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 12 prill 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 10 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 15 mars 2008, bazuar në shkresat e lëndës, gjatë furnizimit me gaz përmes një autocisterne të firmës „P-Gas“, në pikën e shitjes në rrugën „Rrustem Hyseni“ në Prishtinë të firmës „M-Gas Petroll“, në pronësi të parashtruesit të kërkesës, ka rezultuar ndezja e gazit dhe për pasojë kanë

vdekur B.M dhe I.S; kanë marrë lëndime të rënda trupore N.D, M.D dhe A.A, ndërsa gjithashtu janë shkaktuar dëme materiale.

10. Më 17 shtator 2008, Departmenti për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore) ngriti Aktakuzën [PP.I. nr.218-7/08] kundër parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale të shkaktimit i rrezikut të përgjithshëm përcaktuar përmes nenit 291 (Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK).
11. Më 15 qershor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR.nr. 624/2008] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale për të cilën ai ishte akuzuar dhe e dënoi atë me katër (4) vite dhe dhjetë (10) muaj burgim. Gjykata Themelore fillimisht (i) rikualifikoi veprën penale për të cilën akuzohej parashtruesi i kërkesës nga ajo e përcaktuar përmes nenit 291 të KPPK-së në atë të përcaktuar përmes paragrafit 1 në lidhje me paragrafët 6 dhe 9 të nenit 365 (Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm) të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK); dhe (ii) pasi morri në pyetje dëshmitarët dhe shqyrtoi provat përkatëse dhe siç janë shtjelluar saktësisht në Aktgjykimin e lartcekur, konstatoi fajësinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me veprën e lartcekur penale duke marrë parasysh se i njëjti (i) „nuk kishte leje të vlefshme për pompën e benzinës „M - Gas Petroll“; (ii) kishte „shpërfillur kriteret ligjore për ndërtim, pa plan urbanistik, leje ndërtimi, leje mjedisore, etj.,“; dhe (iii) „për pasojë u shkaktua një rrezik i madh për jetërat e njerëzve dhe pronat me vlerë të konsiderueshme, sepse pasi që gazi u ndez, në atë rast nga lëndimet e pësuar vdiqën B.M. dhe I.S., ndërsa lëndime të rënda trupore pësuan N.D., M.D. dhe A.A., si dhe u shkaktuan dëme materiale në automjete dhe ndërtesa”.
12. Më 3 gusht 2017, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës por edhe mbrojtësi i tij, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozimin që ankesat të miratohen si të bazuara, duke e anuluar Aktgjykimin e atakuar dhe duke e kthyer çështjen në rigjykim ose duke e ndryshuar Aktgjykimin përkatës dhe duke e liruar parashtruesin e kërkesës nga akuza. Nga ana tjetër, Prokurori i Prokurorisë Themelore gjithashtu parashtroi ankesë përkitazi me vendimin për dënimin, me propozimin që ankesa të miratohet dhe Aktgjykimi i kontestuar të ndryshohet ashtu që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënime më të rënda me burg.
13. Më 9 mars 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 453/2017] (i) miratoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm sa i përket pjesës që ka të bëjë me vendimin mbi dënimin, duke i shqipëtuar atij dënim më të lehtë, përkatësisht dënim me burgim prej dy (2) vitesh, duke e llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim; ndërsa (ii) refuzoi si të pabazuara pretendimet tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës dhe ato të Prokurorit të Shtetit, përfshirë të gjitha pretendimet që ndërldheshin me

shkeljen e dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljen e ligjit penal.

14. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij paraqitën kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.
15. Përkitazi me të parën, përkatësisht shkeljen e dispozitave të procedurës penale, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të (i) nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 385 (Shkelja e ligjit penal) të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK) lidhur me shqiptimin e dënimit me pretendimin se në përcaktimin e dënimit me burgim, gjykatat më të ulëta kishin *„tejkualuar kompetencat“* ligjore; dhe (ii) nënparagrafëve 10 e 12 të paragrafit 1 të nenit 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale) të KPPRK-së, me pretendimin se është tejkualuar akuza dhe Aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhje me kodin e procedurës, respektivisht. Ndërsa përkitazi me të dytën, përkatësisht shkeljen e ligjit penal, parashtruesi i kërkesës pretendoi se nuk është vërtetuar ekzistenca e elementeve të veprës penale për të cilën është akuzuar e dënuar, sepse *„në kohën e kryerjes së kësaj vepre nuk kam qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, dhe se vepra është kryer nga ana e moskujdesit të furnizuesit, e jo nga ana ime, andaj në asnjë moment në veprimet e mia nuk janë manifestuar elementet e veprës penale që më vihet barrë“*.
16. Më 24 shtator 2018, përgjegje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kishte paraqitur edhe Prokurori i Shtetit, përmes shkresës [KMLP.II.nr.167/18], duke propozuar që pretendimet e parashtruesit të kërkesës të refuzohen si të pabazuara.
17. Më 12 nëntor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML. nr.243/2018] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe e konfirmoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
19. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se Aktgjykimet e kontestuar janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e (i) KPPRK-së, përkatësisht nenin 7 (Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve) të tij sepse në rrethanat e rastit të tij, nuk janë vërtetuar faktet e rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm; dhe (ii) KPRK-së, përkatësisht nenin 20 (Lidhja shkakore) sepse në rrethanat e rastit të tij, nuk është bërë lidhja në mes veprimit ose mosveprimit të tij në raport me pasojat e krijuara.

20. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata (i) „të anulohet Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë“; dhe (ii) „të konstatohen shkelje në drejtim të vlerësimit të drejtë të përgjegjësisë penale në lidhje me veprimet e mia“.

Dispozitat relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kapitulli II Të Drejtat dhe Liritë Themelore

[...]

Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm)

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Neni 20 Lidhja shkakore

Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore.

KAPITULLI XXIX VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË

Neni 365 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm

1. Kushdoqë me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

(...)

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1.ose 2.i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

(...)

9. Nëse vepra penale nga paragrafi 6.i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 7

Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve

- 1. Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.*
- 2. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

- “1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
- 2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

24. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 243/2017] e 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

25. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një aksident të ndodhur në vitin 2008, në njërën nga pikat e shitjes së kompanisë „M-Gas Petroll“, përkatësisht në pikën e vendosur në rrugën „Rrustem Hyseni“ afër Vellueshës në Prishtinë, pikë kjo për të cilën, bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës, si pronarë i firmës „M-Gas Petroll“, nuk e kishte poseduar dokumentacionin e duhur. Aksidenti kishte rezultuar në të vdekur, të lënduar dhe dëme materiale.

27. Gjykata Themelore e kishte konstatuar fajësinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, duke përcaktuar gjithashtu se kjo vepër ishte kryer nga pakujdesia, por duke marrë parasysh që e njëjta kishte rezultuar në vdekjen e një apo më shumë personave, e kishte dënuar parashtruesin e kërkesës e me katër (4) vite dhe dhjetë (10) muaj burg. Fajësia e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës ishte vërtetuar edhe përmes (i) Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe i cili refuzoi si të pabazuara të gjitha pretendimet përkitazi me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal dhe vërtetim të gabuar dhe

jo të plotë të gjendjes faktike, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës më të ulët vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, përkatësisht duke e ulur të njëjtin në vetëm dy (2) vite burgim; dhe (ii) Aktgjykimin të Gjykatës Supreme dhe e cila gjithashtu refuzoi të gjitha pretendimet përkitazi me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, duke vërtetuar Aktgjykimin e gjykatës më të ulët.

28. Gjykatat e rregullta, bazuar në shkresat e lëndës, i bazuan vendimet e tyre në deklaratimet e dëshmitarëve, të dëmtuarëve dhe provave tjera, duke e përcaktuar përgjegjësinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me veprën penale të shkaktimi të rrezikut të përgjithshëm, në raport me pronësinë e tij në kompaninë „M-Gas Petroll“ e në njërin nga pikat e shitjes, e cila nuk ishte e pajisur me lejet e nevojshme për punë, kishte ndodhur aksidenti dhe rrjedhimisht ishte shkakuar rreziku dhe dëmet përkatëse.
29. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar konstatimet e gjykatave të rregullta përkitazi me fajësinë e tij, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Të gjitha pretendimet ishin refuzuar si të pabazuara nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, respektivisht. Të njëjtat nuk e kishin kontestuar faktin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte qenë prezent në vendin e ngjarjes në kohën e aksidentit, për më tepër, duke e shpallur fajtor bazuar në paragrafin 6 të nenit 365 të KPRK-së, ato kishin përcaktuar se vepra penale ishte shkakuar nga pakujdesia, mirëpo bazuar në paragrafët 1, 6 dhe 9 të këtij neni, dhe marrë parasysh rrezikun dhe dëmet, përfshirë vdekjet e shkaktuara, parashtruesit të kërkesës, në cilësi të pronarit të firmës përkatëse, ia kishin përcaktuar përgjegjësinë për veprën penale përkatëse, duke marrë parasysh që, siç u cek më lart, pikës shitëse në të cilën kishte ndodhur aksidenti i mungonin lejet përkatëse të punës.
30. Në këtë aspekt, e përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se objekti në të cilin ka ndodhur aksidenti „*ka qenë objekt montues dhe nuk ka qenë objekt i përhershëm*“ dhe se leja urbanistike nuk ka mund të lëshohet për shkak të mungesës së pëlqimit mjedisor, por se përkundër kësaj „*askush nga Komuna nuk e ka ndaluar punën e tij*“, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se pikës përkatëse të shitjes i mungonte (i) leja e pëlqimit mjedisor dhe ajo ekologjike, kushtet dhe procedura për marrjen e të cilave ishin të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm për mbrojtjen e mjedisit; dhe (ii) leja urbanistike dhe ajo për ndërtim, kompetente për lëshimin e të cilave ishte Komuna e Prishtinës. Në anën tjetër, bazuar në po të njëjtat, rezulton se pika përkatëse e shitjes (i) ishte e pajisur me një konstatim nr.83-1 të 7 qershorit 2007 të lëshuar nga „*inspekcioni i paralandalimit dhe hulumtimit të zjarrit nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Emergjente*“ të Kuvendit Komunal në Prishtinë, në të cilën, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte „*bërë kërkesë për lëshimin e lejes së punës*“; por që (ii) bazuar në shkresat e lëndës dhe sqarimet e dhëna përmes Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit „*ky konstatim përkitazi me zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri i referohet nënstationit të pikës shitëse të gazit të lëngshëm të naftës (propan-butan) në Prishtinë në rrugën "Bajram Kelmendi" -ish Vellusha në të cilën pikë shitëse me aktvendimin e Inspeksionit të tregut të Drejtorisë së Inspeksionit*

të Komunës së Prishtinës llr.09.34-14174 datë 8.06.2007 i është ndaluar veprimtaria kësaj kompanie”.

31. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës vazhdon të kundërshtoj përgjegjësinë e tij përkitazi me veprën penale për të cilën është dënua, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si pasojë e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të kodit penal e atij të procedurës penale, në esencë, për çështje që ndërlidhen me vërtetimin e fakteve dhe raportin e tyre me përgjegjësinë penale të tij.
32. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për interpretim dhe aplikim të gabuar të ligjit dhe vërtetim të gabuar të fakteve, Gjykata do të i trajtoj duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Në këtë aspekt dhe në vijim, Gjykata do të sqaroj se (i) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të konsoliduar tashmë të Gjykatës, pretendimet që ndërlidhen me interpretimin e ligjit dhe vërtetimin e fakteve, në parim, nuk janë çështje që hyjnë në kuadër të juridiksionit të Gjykatës dhe se rrjedhimisht, kjo e fundit nuk mund të i shqyrtoj ato; dhe (ii) pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 7 dhe 20 të KPPRK-së dhe KPRK-së, respektivisht, janë qartazi të pabazuar në baza kushtetuese.
33. Më specifikisht, Gjykata rithekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me interpretimin e ligjit dhe vërtetimin e fakteve, dhe si të tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës por edhe atë të GJEDNJ-së, përbëjnë dhe kualifikohen si çështje „*ligjshmërie*“. Si të tilla, nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe rrjedhimisht, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
34. Këtë qëndrim Gjykata e ka përsëritur vazhdimisht duke theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).

35. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
36. Thënë këtë, Gjykata, gjithashtu ka vënë theks në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës e cila në rrethana caktuar bën përjashtim nga ky parim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritetet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
37. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
38. Megjithatë, dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata konsideron që pretendimet e parashtruesit të kërkesës e që ndërlidhen me interpretimin e gabuar të ligjit, përkatësisht neneve 7 dhe 20 të KPPRK-së dhe KPRK-së, respektivisht, janë qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, se dispozitat e lartcekura janë interpretuar dhe aplikuar në mënyrë qartazi të gabuar, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.
39. Në kontekst të këtij konstatimi, Gjykata thekson se përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës pretendimet rreth nenit 20 të KPRK-së në lidhje me përcaktimin e përgjegjësisë penale në raport me lidhjen shkakore në mes veprimit dhe mosveprimit të tij dhe pasojës përkatëse, specifikisht nuk i ka ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, në esencë ky pretendim ndërlidhjet me përcaktimin e përgjegjësisë së tij penale, dhe kjo çështje është trajtuar detajisht nga gjykatat e rregullta.
40. Gjykata fillimisht rikujton që në këtë aspekt, Gjykata Themelore, kishte arsyetuar, ndër të tjera si në vijim.

"I pandehuri Muhamet Prapashtica, si pronar i firmës "M-Gas Petroll" me seli në rrugën "Vëllezërit Fazliu" në Prishtinë gjatë vitit 2007 si person përgjegjës ka vepruar kundër ligjit, pa leje valide ka ndërtuar pompën e derivateve "M-Gas Petroll", në rrugën "Rrustem Hyseni" në Prishtinë, me c'rast ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë në vlera të mëdha, duke mos përfill kriteret ligjore mbi ndërtim, pa leje urbane, leje ndërtimi, leje ekologjike, etj, ashtu që me datën 15.03.2008, gjatë furnizimit me gaz nga një autocistemë e firmës "p_Gas" nga Peja ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve dhe pasurinë e rëndësishme thelbësore ashtu që ka ardhur deri te ndezja e gazit me c'rast nga lëndimet e marra ka vdekur B.M, dhe I.S, ndërsa lëndime të rënda trupore kanë marrë të dëmtuarit: N.D, M.D dhe A.A, si dhe janë shkaktuar dëme materiale në vetura dhe objekte".

41. Më tej, Gjykata e Apelit kishte refuzuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, duke theksuar si në vijim:

"Duke marrë parasysh këtë gjendje të fakteve, kjo Gjykatë konstaton se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarit Muhamet Prapashtica dhe Besnik Sadiku se nga provat e paraqitura nuk u provua se veprimet e tyre i përmbushin elementet e veprës penale për të cilat ata u shpallën fajtorë. Sipas vlerësimit të kësaj e Gjykate, nga provat e paraqitura u vërtetua pa dyshim se të akuzuarit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat për detyrimet e tyre të punës, ashtu që i akuzuari, duke shpërfillur kriteret ligjore për ndërtim, për lejen urbanistike, lejen e mjedisit dhe kushtet teknike, ndërtoi një pompë benzine në Rrugën „Rrustem Hyseni“ në afërsi të rrezikshme prej 60cm nga ndërtesa e një shtëpie private, ndërsa i akuzuari Besnik Sadiku, pa posedimin e licencës për të transportuar mallra të rrezikshme, e punësoi vozitësin e një autocisterne Faton Canollin pa trajnime adekuate (pa posedim të ADR) për të transportuar mallra të rrezikshme nga Ministria e Transportit dhe me këtë gjatë furnizimit të pompës së benzinës nga një kamion-cisternë (autocisternë) të drejtuar nga shoferi i të akuzuarit Besnik, si rezultat i rrjedhës së gazit u krijua një masë shpërthyes, e cila rezultoi në një shpërthim zjarri i cili shkaktoi rrezik të përgjithshëm me pasoja të rënda për jetërat e njerëzve (dy të vdekur dhe disa të plagosur) dhe dëme të konsiderueshme materiale".

42. Ndërsa e njëjta gjykatë, ndryshoi sanksionin e shqipëtuar nga Gjykata Themelore, duke e zbritur të njëjtin nga katër (4) vite e dhjetë (10) muaj në dy (2) vite burgim efektiv, duke arsyetuar si në vijim:

"duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat Gjykata i konstatoi dhe i vlerësoi në lidhje me të akuzuarin Muhamet dhe faktin që ka kaluar një kohë e gjatë (10 vjet) nga koha e kryerjes së krimit dhe se bazuar në shkresat e lëndës nuk rezulton se i akuzuari ka ra ndesh me ligjin, kjo Gjykatë konstaton se dënimi me burgim kundër të akuzuarit Muhamet ishte shumë i rreptë dhe se qëllimi i dënimit

mund të arrihet edhe me një dënim më të lehtë, andaj i shqipton atij dënimin sikur në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindjen se ky dënim është është adekuat sa i përket rrezikut shoqëror të veprës penale dhe përgjegjësisë së tij penale dhe se me vetë këtë mund të ndikohet tek i akuzuari për të parandaluar kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij”.

43. Në anën tjetër dhe përfundimisht, edhe Gjykata Supreme shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me përgjegjësinë e tij penale dhe vendimit mbi dënimin, duke përfunduar Aktgjykimin e saj, si në vijim:

“Gjykata Supreme nuk i aprovojë as pretendimet e të dënuarit Muhamet Prapashtica lidhur me lartësinë e dënimit të shqiptuar. Gjykata e Apelit e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket këtij të dënuari duke ia marr parasysh, përveq rrethanave lehtësuese të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, edhe rrethanat se te i denuari ka kaluar një kohë e gjatë prej 10 (dhjetë) viteve nga koha e kryerjes së veprës penale, duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve. Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ultë drejtë kanë aplikuar ligjin penal kur në veprimet e të dënuarit është konstatuar se janë manifestuar gjitha elementet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.9 lidhur me par 6 dhe par. 1 të KPRK-se e poashtu edhe sa i përket provave të administruara duke i vlerësuar ato vec e vec; dhe të gjitha s'bashku, duke dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me provat, besueshmërinë dhe vlerën e tyre”.

44. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se të tri gjykatat e rregullta në fakt saktësisht kishin përcaktuar arsyet mbi bazën e të cilave parashtruesit të kërkesës i ishte vënë përgjegjësia penale për veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, sepse bazuar në Aktgjykimet përkatëse dhe arsyetimet e lartcekura, gjykatat e rregullta kishin konstatuar se veprimi ose mosveprimi përkatës ndërlidhej me respektimin e dispozitave ligjore përkitazi me lejet e nevojshme të punës ndërsa pasoja ishte shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm dhe që në rrethanat e rastit konkret, kishte rezultuar në disa të vdekur dhe rëndë të lënduar, përtej dëmeve tjera materiale. Gjykata rikujton që neni 365 i KPRK-së përcakton që kushdo që shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, edhe nëse një gjë të tillë e ka bërë nga pakujdesia, siç është përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni dhe i aplikueshëm sipas gjykatave të rregullta në rrethanat e rastit konkret, por që ka rezultuar në vdekjen e një apo më shumë personave, dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet, siç është përcaktuar në paragrafin 9 të të njëjtin nen. Në rrethanat e rastit konkret, kishin vdekur dy (2) persona, kishin marrë lëndime të rënda trupore tre (3) persona dhe ishin shkaktuar dëme materiale. Përkundër këtyre rrethanave, dhe pasi që gjykatat e rregullta kishin marrë parasysh rrethanat rëndësuese dhe lehtësuese në rastin konkret, parashtruesin e kërkesës e kishin dënuar me vetëm dy (2) vite burgim, duke e llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

45. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me nenin 20 të KPRK-së, ndërlidhen edhe me nenin 7 të KPRK-së,

interpretimin e gabuar të të cilit parashtruesi i kërkesës gjithashtu e pretendon dhe i cili përcakton detyrimin e përgjithshëm për gjykatat përkitazi me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të fakteve. Një detyrim i tillë buron edhe nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, edhe për sa i përket detyrimit për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të fakteve por edhe për as i përket detyrimit të gjykatave të rregullta për të vlerësuar në mënyrë të duhur parashtruesat, argumentet dhe provat e dorëzuara nga palët. (Për sa i përket këtij të fundit, shih rastin e Gjykatës KIO7/18, me parashtrues „*Celiku Rollers*“, Aktgjykim i 20 janarit 2020, në të cilin janë shtjelluar parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të aplikueshme në këtë kontekst).

46. Megjithatë, Gjykata thekson faktin se dispozita e lartcekur, por për më tepër, edhe detyrimi që ajo ngërthen, nuk mund të interpretohet si të izoluar nga dispozitat tjera të kodit penal dhe atij të procedurës penale. Më saktësisht, një detyrim i tillë është i rregulluar dhe i kushtëzuar përmes rregullave procedurale, e në rrethanat e rastit konkret, përmes atyre të kodit procedural penal. Specifikisht, dhe në kontekst të çështjeve që ndërlidhen me vërtetimin e drejtë të fakteve, bazuar në paragrafin 1.3 të nenit 383 (Arsyet për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit), përbëjnë një nga bazat për ngritjen e ankesës kundër një Aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Gjykatë të Apelit, krahas pretendimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionet penale, të përcaktuara në paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.4 të këtij neni, respektivisht. Vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike është më tej i precizuar në nenin 386 (Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike) të KPPRK-së, dhe bazuar në të cilin, i njëjti ekziston atëherë kur gjykata (i) ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose të incizimit teknik vënë në pikëpyetje saktësinë ose bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme; apo (ii) nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm. Në anën tjetër, bazuar në paragrafin 2 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë (i) nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike në Gjykatën Supreme e (ii) as kundër vendimit të saj përmes të cilës është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.
47. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që bazuar në dispozitat e lartcekura procedurale, pretendime që ndërlidhen me vërtetimin e drejtë të fakteve, në parim, mund të paraqiten vetëm deri në Gjykatën e Apelit. Në procedura të mëtejme, dhe fillimisht ato në Gjykatën Supreme, ankesat përkatëse mund të ndërlidhen vetëm më pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e ligjit penal, shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe ose shkelje të tjera që mund të kenë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, siç është përcaktuar në nenin 432 të KPPRK-së. Për më tepër që, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit kishte shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar të fakteve dhe të cilat, ishin të ndërlidhuara me dëshminë e të akuzuarit F.C, dhe i cili ishte vozitës i autocisternës të kompanisë „P-Gas“, e e cila në momentin e aksidentit e

kishte bërë furnizimin me gaz të firmës së parashtruesit të kërkesës në pikën e shitjes së tij, duke pretenduar se përgjegjësia penale bie mbi furnizuesin.

48. Gjykata thekson se Gjykata e Apelit kishte shqyrtuar këto pretendime të parashtruesit të kërkesës lidhur me faktet e rastit dhe kishte konstatuar, ndër të tjera, si në vijim:

“Duke pas parasysh këtë gjendje të fakteve kjo Gjykatë vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve Muhamet Prapashtica dhe Besnik Sadiku se nga provat e administruara nuk është provuar se në veprimet e tyre përmbushen elementet e veprës penale për të cilën ata janë shpall fajtor. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate nga provat e administruara pa mëdyshje është vërtetuar se të akuzuarit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e punës së tyre ashtu që i akuzuari Muhamet duke mos përfill kriteret ligjore për leje urbane, leje ekologjike, kushte teknike ka ndërtuar pompën e derivateve në rrugën "Rrustem Hyseni" në afërsi të rrezikshme prej 60 m nga objekti shtëpi private, kurse i akuzuari Besnik Sadiku duke mos poseduar licencë për transportin e mallrave të rrezikshme ka punësuar si vozitës të autobotit Faton Canollin pa trajnim adekuat (pa posedim të ADR) për transportimin e lëndëve të rrezikshme nga Ministria e Transportit dhe me këtë gjatë furnizimit të pompës së derivateve nga kamioni cisterne-autoboti të cilin e ka vozitur punëtori i të akuzuarit Besnik si pasojë e rrjedhjes së gazit është formuar masë eksplozive që ka rezultuar me shpërthim të zjarrit që ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm me pasoja të rënda për jetën e njerëzve (dy të vdekur dhe disa të lënduar) dhe dëm të konsiderueshëm material.”

49. Për më tepër, Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, ishte dënuar edhe pronari i kompanisë „P-Gas“, përkatësisht B.S, ndërsa ndaj shoferit F.C, bazuar në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ishte veçuar procedura penale.
50. Rrjedhimisht dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata thekson se (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ishin paraqitur para Gjykatës së Apelit dhe e njëjta i kishte trajtuar dhe arsyetuar ato, duke i refuzuar si të pabazuara; (ii) pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljen e ligjit penal ishin paraqitur edhe para Gjykatës Supreme dhe e njëjta i kishte trajtuar dhe arsyetuar ato, duke i refuzuar si të pabazuara; dhe (iii) pretendimet e parashtruesit të kërkesës para Gjykatës e që ndërlidhen me intepretimin e dispozitave të lartcekura, e që në esencë ngërthejnë në vetvete detyrimin për vërtetim të gjendjes faktike, siç është sqaruar më lart, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. Bazuar në vlerësimin e Gjykatës, gjykatat e rregullta nuk kanë “aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar” dhe rrjedhimisht konstatimet e tyre nuk kanë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës, dhe për pasojë, procedura në tërësinë e saj ka qenë e drejtë dhe joarbitrare.

51. Për më tepër, dhe në këtë kontekst, Gjykata rithekson se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substancial*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 prillit 2019, paragrafi 85).
52. Në këtë drejtim dhe në parim, pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, mund të ndërlidhen me pamundësinë e procedurave kontradiktore; pamundësinë që në faza të ndryshme të procedurave, pala të sjell argumentet dhe provat që i konsideron të rëndësishme për rastin e tij/saj; dhe/ose pamundësinë e kontestimit në mënyrë efektive të argumenteve dhe provave të paraqitura nga pala kundërshtarë. Në të kundërtën, dhe nëse të gjitha argumentet e palës e të cilat, shikuar në mënyrë objektive, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit përkatës, u dëgjuan dhe u shqyrtuan në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta, atëherë, në parim, procedura në tërësinë e saj, duhet të konsiderohet si e drejtë. (Shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafi 86).
53. Gjykata rithekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rrethanat e rastit konkret nuk ndërlidhen me padrejtësi procedurale, dhe për më tepër, të njëjtat nuk mbështesin mundësinë se procedurat para gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
54. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI119/17, cituar më lart, paragrafi 88).
55. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
56. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 23 të Kushtetutës. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që

ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).

57. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283). Për më tepër, pretendime të tilla, e të cilat nuk qartësojnë shkeljet e pretenduara në mënyrë adekuate, janë gjithashtu të papranueshme bazuar në nenin 48 të Ligjit në lidhje me pikën d) të paragrafit 1 të Rregullit 39 të Rregullores së punës, mbi bazën e të cilave parashtruesit e kërkesave kanë për detyrë që kërkesat e tyre të i qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të i paraqesin faktet dhe pretendimet përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendohet se u janë cenuar.
58. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të nenit 23 të Kushtetutës dhe për rrjedhojë, edhe këto pretendime, në vazhden e pretendimeve tjera në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe të cilat u shtjelluan dhe u sqaruan më lart, duhet të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi